

AKT SHITJE - BLERJE KUOTASH

Ne Shkoder sot me date 04.02.2002 (kater shkurt dymije e dy), ditën e hene, ne Dhomen e Noterise Shkoder dhe para meje, noter publik Arben Salim Kopliku, me seli ne rrugen "Don Boscho", karrshi Gjykates Faktit Shkoder, u paraqiten personalisht palet kontraktuese :

Shitesi : BEHADIR KOPLIKU, i biri i Mit'hatit, i dtl 1949, lindur e banues ne lagje "Salo Halili" Shkoder.

Bleresi : MARK GJEKA, i biri i Lecit, i dtl 1964, lindur e banues ne Shkoder lagje "Perlat Rexhepi" rruga "Filip Shiroka" nr

Per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leternjoftimeve te tyre personale, dhe pasi u sigurova se i kane te gjitha aftesite e kerkuara nga ligja, me kerkesen e tyre redaktova kete akt shitje-blerje pasurie te luajtshme, i cili pershkruhet si me poshte :

Shitesi Behadir Kopliku eshte ortak i shoqerise "B.M.Konstruksion" SH.P.K. rregjistruar si person juridik sipas vendimit Nr 14258 Regj. dt 21.03.1996 te Gjykates Rrethit Tirane per te ushtruar aktivitetin ne fushen e ndertimit (projektim e zbatim etj), shoqeria ka seline ne qytetin e Shkoders dhe ne baze te statutit ka nje kapital themeltar prej 100 000 leke e ndare kjo ne 50 % seicili nga ortakët (50 % Behadir Kopliku e 50 % Mark Gjeka).....

Shitesi Behadir Kopliku deklaroi se i shet ortakut Mark Gjeka kuoten e tij te kapitalit themeltar te vendosur ne statut qe arrin vleren 50 000 leke (1 x 50 000).....

Bleresi Mark Gjeka deklaroi se eshte dakort te bleje per shumen e mesiperme kuoten e kapitalit themeltar te ortakut tij Behadir Kopliku.....

Kjo shitje kryhet me synimin qe shoqeria "B.M.Konstruksion" Sh.p.k. te vazhdoje aktivitetin me ortak te vetem z. Mark Lec Gjeka.....

Shitesi Behadir Kopliku deklaroi se ka marre nga bleresi Mark Gjeka shumen takuese per shitjen e kuotes se tij te kapitalit themeltar te shoqerise e perbere kjo nga 50 % te shumes prej 100 000 leke.....

Kjo kontrate u lidh me titull akt shitje-blerje kuotash dhe pjese e pandashme qe i bashkengjiten ketij akti jane :

1. vendim gjyqesor nr 14258 dt 21.03.1996 i Gjykates Tirane per rregjistrimin e personit juridik "B.M.Konstruksion" Sh.p.k.
2. kopje e statutit te shoqerise "B.M.Konstruksion" Sh.p.k.
3. akt themelimi i shoqerise "B.M.Konstruksion" Sh.p.k.

Akti i shitjes pasi ju lexua paleve kontraktuese duke e gjetur konform ligjit dhe vullnetit te lire e te plote te tyre, u nenshkrua prej tyre ne prezencen time si me poshte :

PALET KONTRAKTUESE


SHITESI

BEHADIR KOPLIKU



BLERESI

MARK GJEKA



NOTER

ARBEN SALIM KOPLIKU

